

Në qytetin Kalkilye, në veri të Bregut Perëndimor, trupat izraelite qëlluan mbi demonstruesit palestinez dhe plagosën dy persona, raporton Anadolu Agency (AA).

Kryesuesi i këshillit Azun, Nemr Bedvan tha për AA tha se në lindje të Kalkilye ndodhen dhjetëra palestinez, dhe se protestat janë organizuar për të hapur zonën që qeveria izraelite mban të mbyllur.

Ushtarët izraelitë ndërhyjnë kundër demonstruesve me gaz lotsjellës, bomba zhurmuese si dhe përdorën plumba plastikë. Autoritetet izraelite ende nuk janë prononcuar në lidhje me këtë incident.